



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.8

9 shkurt

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe	
Vendim i KM nr.54, datë 26.1.2011	Për pjesëmarrjen në stërvitje të dy kompanive të Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC), në Hohenfels, Gjermani.....	181
Vendim i KM nr.55, datë 26.1.2011	Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes qendrore.....	181
Vendim i KM nr.56, datë 19.1.2011	Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimi ndaj procedurave të ankandit publik apo vendimeve për përjashtim nga to, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.....	183
Vendim i KM nr.62, datë 26.1.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen – Kalimash.....	184
Vendim i KM nr.64, datë 26.1.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.1293, datë 29.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar.....	185
Urdhër i MB nr.42, datë 31.1.2011	Për specifikimet teknike të akteve, të certifikatave dhe procesverbaleve që plotëson dhe lëshon Shërbimi i Gjendjes Civile	186
Vendim i BSH nr.3, datë 19.1.2011	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut operacional”.....	193

Vendim i BSH nr.4, datë 19.1.2011	Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale të sigurisë, në ambientet në të cilat kryhen veprimtaritë bankare dhe financiare”...	208
Vendim i ERE nr.4, datë 25.01.2011	Për licencimin e shoqërisë “Ferar Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	213

VENDIM
Nr.54, datë 26.1.2011

**PËR PJESËMARRJEN NË STËRVITJE TË DY KOMPANIVE TË FORCAVE TOKËSORE
TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË QENDRËN
E BASHKUAR NDËRKOMBËTARE TË GATISHMËRISË (JMRC), NË HOHENFELS,
GJERMANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e dy kompanive të Forcave Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me personel 200 (dyqind) ushtarakë, në stërvitjen e përbashkët, në Qendrën e Bashkuar Ndërkombëtare të Gatishmërisë (JMRC) në Hohenfels, Gjermani.

2. Qëllimi i kësaj stërvitjeje është trajnimi i trupave para dërgimit me mision në Afganistan.

3. Kohëzgjatja e stërvitjes është nga data 7-23 shkurt 2011.

4. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.55, datë 26.1.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME,
PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2011, në njësitë e qeverisjes vendore, është 1146 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Përfundimisht, për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, për punonjësit e Institutit të Statistikave, të cilët do të merren me anketimin e forcave të punës, për 5 (pesë) punonjësit arkivistë, në aparatën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për 5 (pesë) punonjësit në sektorin e pagesave dhe të dëshmshpërblimeve, në Ministrinë e Financave, nuk zbatohet pika 3 e vendimit nr.1703, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe veprimtarive sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

3. Përfundimisht, për punonjësit e kontraktuar nga Instituti i Statistikave, të cilët do të merren me regjistrimin e popullsisë, miratimi i numrit të tyre, afatet kohore dhe të tjera specifitime të përcaktohen nëpërmjet një udhëzimi të përbashkët ndërmjet INSTAT-it dhe Ministrisë së Financave

4. Përfundimisht, për Qendrat e Transferimit të Teknologjisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për shkak të veçorisë së punës, pagesa e punonjësve të kontraktuar përllëgaritet sipas volumit të punës së kryer.

